



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:018322
Datë: 14.06.2021
Numri i dokumentit: 01882465

P.nr.835/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit S. A. nga fshati Gumnishtë, Komuna e Gjilanit për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së duke vepruar sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1460/2017, PP.II.nr.1602/2017, PP.II.nr.1559/2017, PP.II.nr.2057/2017, PP.II.nr.1797/2019, PP.II.nr.1887/2019, PP.II.nr.1888/2019 dhe PP.II.nr.1889/2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 11.06.2021 mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri S. A. nga babai A. dhe nëna F., e lindur S., i lindur me datë 22.04.1984 në Gjilan ndërsa me vendbanim në fshatin Gumnishtë, Komuna e Gjilanit, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i pa punësuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I.

Sepse me date 29.07.2017, rreth orës 19:30 minuta, në fshatin Cërnice, Komuna e Gjilanit, në vendin e quajtur "Butazh", i administruar nga Autoriteti Pyjor Komunal- Zyra në Gjilan, me qelli vjedhje ka prerë në mënyrë të palejueshme me sharrë motorike 76 copa trungje të llojit "Bung", me diametër 12-14 centimetër, në lartësi prej 6 metra dhe në vëllim të përgjithshëm prej 2.61 m³ dhe në këtë mënyrë të dëmtuarës APK në Gjilan i shkakton dëm material në vlerë të papërcaktuar.

II.

Sepse me date 20.08.2017, rreth orës 17:00 h, në fshatin Cërnice, Komuna e Gjilanit, në vendin e quajtur "Butatel", i administruar nga Autoriteti Pyjor Komunal- Zyra në Gjilan, me qellim vjedhje ka prerë në mënyrë të palejueshme me sharrë motorike 82 copa trungje të llojit "Bung", me diametër 12-14 centimetër, në lartësi prej 6 metra dhe në vëllim të përgjithshëm prej 2.81 m³ dhe në këtë mënyrë të dëmtuarës APK në Gjilan i shkakton dëm material në vlerë të papërcaktuar.

III.

Sepse me date 16.08.2017, rreth orës 06:20 minuta, në fshatin Cërnice, Komuna e Gjilanit, në vendin e quajtur "Butazh", me qellim vjedhje ka prerë me sharrë motorike 72 copa trungje të llojit "Bung", me diametër 12-14 centimetër, në lartësi prej 6 metra dhe në vëllim të përgjithshëm prej 2.05 m³ dhe në këtë mënyrë të dëmtuarës APK në Gjilan i shkakton dëm material në vlerë të papërcaktuar.

IV.

Sepse me date 19.08.2017, rreth orës 17:50 minuta, në fshatin Cërnicë, Komuna e Gjilanit, në vendin e quajtur “Butazh”, me qellim vjedhje ka prerë me sharrë motorike 64 copa trungje të llojit “Bung”, me diametër 12-14 centimetër, në lartësi prej 6 metra dhe në vëllim të përgjithshëm prej 2.19 m³ dhe në këtë mënyrë të dëmtuarës APK në Gjilan i shkakton dëm material në vlerë të papërcaktuar.

V.

Sepse me date 27.10.2017, rreth orës 13:00 h, në fshatin Cërnicë, Komuna e Gjilanit, në vendin e quajtur “Ramnibej”, me qellim vjedhje ka prerë me sharrë motorike 78 copa drunjë të njoma të llojit “Bung”, me diametër 10-14 centimetër, në lartësi prej 6 metra dhe në vëllim të përgjithshëm prej 2.22 m³ të cilat i ka bartur me traktor të llojit “Ferguson”, me ram dhe në këtë mënyrë të dëmtuarës APK në Gjilan i shkakton dëm material në vlerë të papërcaktuar.

VI.

Sepse me date 02.10.2019, rreth orës 17:00 h, në fshatin Cërnicë, Komuna e Gjilanit, në vendin e quajtur “Butazh”, me qellim vjedhje ka prerë me sharrë motorike 58 copa trungje të llojit “Bung”, me diametër 14-16 centimetër, në lartësi prej 7 metra dhe në vëllim të përgjithshëm prej 3.17 m³ të cilat i ka bartur me traktor të llojit “Ferguson”, me ram dhe në këtë mënyrë të dëmtuarës APK në Gjilan i shkakton dëm material në vlerë të papërcaktuar.

VII.

Sepse me date 15.10.2019, rreth orës 17:00 h, në fshatin Cërnicë, Komuna e Gjilanit, në vendin e quajtur “Butazh”, me qellim vjedhje ka prerë me sharrë motorike 54 copa trungje të llojit “Bung”, me diametër 14-16 centimetër, në lartësi prej 7 metra dhe në vëllim të përgjithshëm prej 2.95 m³ dhe në këtë mënyrë të dëmtuarës APK në Gjilan i shkakton dëm material në vlerë të papërcaktuar.

VIII.

Sepse me date 21.10.2019, rreth orës 14:30 minuta, në fshatin Cërnicë, Komuna e Gjilanit, në vendin e quajtur “Butazh”, me qellim vjedhje ka prerë me sharrë motorike 62 copa trungje të llojit “Bung”, me diametër 14-16 centimetër, në lartësi prej 6 metra dhe në vëllim të përgjithshëm prej 3.02 m³ të cilat i ka bartur me traktor të llojit “Ferguson”, me ram dhe në këtë mënyrë të dëmtuarës APK në Gjilan i shkakton dëm material në vlerë të papërcaktuar.

IX.

Sepse me date 01.11.2019, rreth orës 14:00 h, në fshatin Cërnicë, Komuna e Gjilanit, në vendin e quajtur “Butazh”, me qellim vjedhje ka prerë me sharrë motorike 65 copa trungje të llojit “Bung”, me diametër 12-16 centimetër, në lartësi prej 6 metra dhe në vëllim të përgjithshëm prej 2.23 m³ dhe në këtë mënyrë të dëmtuarës APK në Gjilan i shkakton dëm material në vlerë të papërcaktuar.

-Me çka ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së,

Andaj, në bazë të neneve 4,38,39,40,43,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe nenit 248 dhe 365 të KPP-ës, të pandehurin e lartcekur:

E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind euro) të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 5 muajve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë në këste të barabarta.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

E dëmtuara APK në Gjilan për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € (tridhjetë euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 22.08.2017, 12.09.2017, 13.09.2017, 01.11.2017, 07.11.2019, 26.11.2019, 02.12.2019 dhe 03.12.2019 ka ngritur aktakuzat PP.II.nr.1460/2017, PP.II.nr.1602/2017, PP.II.nr.1559/2017, PP.II.nr.2057/2017, PP.II.nr.1797/2019, PP.II.nr.1887/2019, PP.II.nr.1888/2019 dhe PP.II.nr.1889/2019 kundër të pandehurit S. A. nga fshati Gumnishtë, Komuna e Gjilanit për shkak të veprave penale vjedhja e pyllit nga neni 358 paragrafi 1 i KPRK-ës numër 06/L-082 respektivisht veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 i KPRK-ës numër 06/L-074.

Me datë 11.06.2021 pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit dhe i pandehuri S. A. i sjellur nga ana e policisë meqenëse për të njejtin paraprakisht ishte lëshuar urdhërarrest nga ana e kësaj gjykate. Në këtë seancë duke pasur parasysh se ndaj të pandehurit të lartcekur ishin ngritur tetë aktakuza për vepra penale të vjedhjes së pyllit gjykata pas dëgjimit të palëve dhe me qëllim të ekonomizimit të procedurës penale kishte marrë aktvendim për bashkimin e procedurave penale ndaj tij dhe atë për lëndët me numra P.nr.835/2017, P.nr.966/2017, P.nr.973/2017, P.nr.1212/2017, P.nr.1001/2019, P.nr.1049/2019, P.nr.1082/2019 dhe P.nr.1077/2019 dhe më pas prokurori i shtetit para leximit të aktakuzës ka bërë ricilësimin juridik të veprave penale ashtu që veprat penale vjedhja e pyllit nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-ës numër 06/L-082 i ka ricilësuar në veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 i KPRK-ës numër 06/L-074 i cili është në fuqi tani dhe më pas të njëjta i ka cilësuar si një vepër penale në vazhdim dhe atë vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës numër 06/L-074 dhe pas leximit të dispozitivave të aktakuzave lëndore nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri i lartcekur ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi aktakuzat dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e tyre me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPRK-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata në seancën e shqyrtimit fillestar pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP-ës dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: fletë paraqitja për dëmtimin e pyllit me numër 53/2017 i datës 11.08.2017, fletë paraqitja për dëmtimin e pyllit me numër 58/2017 i datës 07.09.2017, fletë paraqitja për dëmtimin e pyllit me numër 55/2017 dhe 57/2017 të datës 28.08.2017, fletë paraqitja për dëmtimin e pyllit me numër 104/2017 i datës 03.11.2017, fletë paraqitja për dëmtimin e pyllit me numër 22/2019 i datës 22.10.2019, fletë paraqitja për dëmtimin e pyllit me numër 25/2019 i datës 19.11.2019, fletë paraqitja për dëmtimin e pyllit me numër 32/2019 i datës 01.11.2019 dhe fletë paraqitja për dëmtimin e pyllit me numër 24/2019 i datës 19.11.2019, ditari i rojtarit të pyllit me numër 156/2017, ditari i rojtarit të pyllit me numër 58/2017 si dhe shkresat e tjera të lëndës po ashtu gjykata në këtë çështje penalë juridike gjeti se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartë cekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i pandehuri S. A. nga fshati Gumnishtë, Komuna e Gjilanit ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën të përshkruar si në pikat I-IX të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit e cila nga provat materiale në shkresat e lëndës del të jetë e lartë meqenëse i pandehuri me rastin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm për veprimet e tija dhe veprën penale e ka kryer me dashje dhe atë direkte po ashtu me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh pranimin e fajit nga ana e të pandehurit si dhe rrethanat personale të kryesit.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata mori faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tija, ka kërkuar falje për këto veprime duke shtuar se këto veprime i ka bërë për shkak të gjendjes së varfër ekonomike aq të keqe sa që sipas tij edhe gjarpërinjtë i dalin brenda shtëpisë dhe se njëkohësisht është mbajtës i familjes dhe i papunë, asnjë nga anëtarët e familjes së tij nuk i punon, po

ashtu si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata mori edhe premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale ndërsa rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori dashjen e lartë të shfaqur nga ana e tij meqenëse nga shkresat e lëndës dhe provat të cilat gjinden në to del se i pandehuri këtë vepër e ka kryer me dashje dhe atë direkte duke e ditur që veprimet për të cilat është shpallur fajtor janë të ndaluara dhe përkundër kësaj i njejtë ka dëshiruar dhe ka ndërmarrë veprimet për shkaktimin e tyre, andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 72 të KPRK-ës gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Duke pasur parasysh se në dispozitivat e aktakuzave lëndore është cekur vlera e dëmit mirëpo lidhur me llogaritjen e këtij dëmi nuk ka ndonjë ekspertizë të veçantë por e njëjta është bërë në bazë të kalkulimit të përgjithshëm të cilën e bënë vet e dëmtuara gjykata konsideron se këto të dhëna nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë e as të pjesërishtë të kërkesës pasurore juridike andaj edhe bazuar në nenin 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës të dëmtuarën APK në Gjilan për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € (tridhjetë euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.835/2017, me datë 11.06.2021

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermahaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.